

**Dr. Tony B. Watlington, Ed.D.**  
Superintendent

22 Korrik, 2022

Të Dashur Familje dhe Komunitet i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Muajin e kaluar, u nderova të emërohesha superintendentet i kesaj drejtorie të mirë arsimore . Një nga veprimet e mia të para ishte zbulimi i prioriteteve të mia 100-ditore. Këto prioritete detajojnë veprimet e qëllimshme që po ndërmarr për të njohur Filadelfian dhe Drejtorinë Arsimore dhe pasqyrojnë një qasje trefazore për të vendosur një themel të fortë për të përmirësuar rezultatet për të gjithë studentët dhe për të arritur Qëllimet dhe Objektivat e Bordit. Faza e 1 e *Dëgjimit dhe Mësimi* së bashku me rezultatet e Fazës 2, *Ekipi i Tranzicionit* do të informojë Fazën 3, e cila është zhvillimi i një plani të ri strategjik për Drejtorinë Arsimore të Filadelfisë në pranverën e vitit 2023.

Zbatimi i prioriteteve të mia 100-ditore është duke u zhvilluar në mënyrë aktive. Këtu janë disa pika kryesore të arritjeve të mia deri tani:

**Faza 1 Dëgjimi dhe Mësimi** - Kam përfunduar 25 seanca gjithsej me studentë, drejtorë, ndihmësdrejtorë, personel shkollor dhe anëtarë të tjerë të SDP -së, prindër dhe anëtarë të komunitetit. Unë jam duke mësuar shumë nga njohuritë dhe opinionet që keni ndarë dhe mezi pres të dëgjoj më shumë prej jush. Më shumë seanca familjare janë planifikuar për muajin Gusht. Ju mund të regjistroheni për një sesion [KËTU](#). Ju gjithashtu mund të ndani mendimet dhe idetë tuaja duke plotësuar [këtë anketë](#).

**Fazës 2 Ekipi i Tranzicionit** - Javën e kaluar, unë nisa Ekipin tim të Tranzicionit, i cili ka më shumë se 80 anëtarë të komunitetit të Filadelfias së bashku me drejtues arsimorë jo-SDP për të vlerësuar pesë fusha të Drejtorisë sonë Arsimore: arritjet e nxënësve, operacionet, anti-racizmi Kultura e drejtorisë, angazhimi dhe komunikimi i komunitetit, dhe përvoja të mira shkollore. Një raport me rekomandime afatshkurtra dhe afatgjata për përmirësime në secilën fushë do të ndahet këtë vjeshtë.

Unë kam qenë gjithashtu duke u takuar me zyrtarë të zgjedhur të qytetit dhe të shtetit, drejtuesit e sindikatave, personelin e drejtorisë dhe shumë drejtues të tjerë të Filadelfias dhe anëtarë të komunitetit për të diskutuar një angazhim të përbashkët për punën e vështirë që kemi përpara për të përmirësuar rezultatet për të gjithë nxënësit e shkollave publike të Filadelfias.

Ju ftoj të mësoni më shumë rreth prioriteteve dhe progresit tim 100-ditor dhe të takoni Ekipin e Tranzicionit në [philasd.org/100days](http://philasd.org/100days).

Faleminderit që ma besuat këtë përgjegjësi të madhe. Mezi pres të vazhdojmë punën tonë së bashku.

Në partneritet për fëmijët,

A handwritten signature in a cursive script that reads "Tony".

Dr. Tony B. Watlington  
Superintendent  
Drejtoria Arsimore e Filadelfias